

VENDIM
Nr. 249, datë 20.4.2023

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURISË
ME NUMËR 1/243, NË ZONËN KADASTRALE 8150, TIRANË, DHE PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN NR. 219, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë me numër 1/243, në zonën kadastrale 8150 Tiranë, sipas hartës treguese që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e infrastrukturës vendore.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 608, datë 7.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve te Ministria e Zhvillimit Urban, të pronave me emërtimin ‘Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve’, ‘Godina nr. 2 MRP’ dhe ‘Klubi MRP – kati I, i godinës së MRP-së’, dhe për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1068, datë 29.12.2010 dhe nr. 250, datë 24.4.2003, të ndryshuar”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

ELION SEMANAJ



A.IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 8150 NR.PASURISË 1/243 VOL. 30 FOL. 192

INDEKSI I HARTËS TR-P-12 SHKALLA 1:500

ADRESA PASURISË: Rrethi:TIRANË, Q/F

B.KUFIZIMET:

C.PRONARI

V. _____

L. _____

J. _____

P. _____

D.Data: ____/____/2018, Ora _____, Punoj _____

[Signature]

